

20161423402

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 1

Në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), në nenin 107 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"RTM-ja në Republikën e Maqedonisë siguron së paku një servis programor televiziv në gjuhën maqedonase dhe një servis programor televiziv në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetareve që është e ndryshme nga gjuha maqedonase, që do të transmetojnë program 24 orë çdo ditë të javës, si dhe servis programor televiziv që do të transmetojë program në gjuhët e bashkësive tjera joshumicë në Republikën e Maqedonisë."

Neni 2

Pas nenit 144 shtohet Kapitull i ri IX si vijon:

"IX. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE".

Neni 3

Në nenin 145 në paragrafin (1) numri "100.000" zëvendësohet me numrin "50.000".
Në paragrafin (2) fjalët: „3.000 deri në 5.000" zëvendësohen me numrin "1.500".

Neni 4

Në nenin 146 në paragrafin (1) numri "20.000" zëvendësohet me numrin "10.000".
Në paragrafin (2) fjalët: „1.000 deri në 3.000" zëvendësohen me numrin "500".

Neni 5

Titulli i kapitullit "IX. DISPOZITA NDËSHKIMORE" shlyhet.

Neni 6

Në nenin 147 në paragrafin (1) fjalët: "10.000 deri 20.000" zëvendësohen me numrin "5.000".
Në paragrafët (2) dhe (3) fjalët: "1.000 deri 3.000" zëvendësohen me numrin "500".

Neni 7

Në nenin 148 në paragrafin (1) fjalët: "5.000 deri 10.000" zëvendësohen me numrin "2.500".
Në paragrafin (2) fjalët: „500 deri në 1.000" zëvendësohen me numrin "250".

Neni 8

Në nenin 149 në paragrafin (1) fjalët: "3.000 deri 5.000" zëvendësohen me numrin "1.500".
Në paragrafin (2) fjalët: „1.000 deri në 1.500" zëvendësohen me numrin "500".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".